



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë praktike - Arabisht

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 40 seminare

Viti / Semestri: Viti II / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Master i Shkencave në ‘‘Komunikim Ndërkulturor dhe Turistik Trigjuhësh

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të jetë në gjendje: Të shkruajë dhe të lexojë saktë në arabisht; Të njohë rregullat kryesore gramatikore të gjuhës arabe; Të mësojë leksikun bazë nga fusha të ndryshme të jetës së përditshme; Të kuptojë dhe krijojë tekste elementare dhe të jetë në gjendje të marrë pjesë në dialogje të thjeshta

Objektivat specifike lëndore:

1. Studenti duhet të ketë njohuri në fushën e gramatikës;
2. Studenti është mire që të ketë aftësi në mësimin e gjuhëve të huaja

Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të këtij niveli, studenti duhet:

- Të dijë të shkruajë dhe të lexojë pa vështirësi tekstet e shkruara në arabisht – me diakrite.
- Të formojë një bagazh leksikor dhe njohuri gramatikore bazë që t'i mundësojnë një komunikim bazik në gjuhën arabe.
- Të jetë në gjendje të përshkruajë objektet (ambjentin) e klasës së mësimin, ambjentin e banimit, aktivitetin e përditshëm.
- Të jetë në gjendje të përshkruajë kohën, ditët e javës, muajt dhe stinët e vitit, ngjyrat etj.
- Të njohë me shkrim dhe dëgjim numërorët arabë.
- Të formulojë pyetje bazike për gjithë sa më sipër.